

**Titulli i projektit**

Hartimi i një plani strategjik të zhvillimit të turizmit në zonën funksionale Malësi e Madhe

Tipi i projektit

Sektori strategjik i turizmit

Vendndodhja e projektit

Zona Funksionale Malësi e Madhe

Buxheti i paravlerësuar

20,000 Euro

Përshkrimi dhe analiza e problemit/ëve

Analiza ekonomike e Zonës Funksionale veçon turizmin si një ndër dy sektorët kyç për zhvillimin e ardhshëm ekonomik të Malësisë së Madhe. Ky sektor është zhvilluar deri më tani i ndarë sipas njësive vendore. Për këtë arsye, një hap i parë i rëndësishëm për zhvillimin tërësor të tij në zonën funksionale është hartimi i një plani strategjik zhvillimi, që të përfshijë të gjitha pikat turistike, vlerat natyrore, kulturore, arkeologjike e historike të zonës si një e tërë. Planin duhet të jetë në koherencë dhe me Draft-Strategjinë Kombëtare të Turizmit 2014-2020.

Qëllimi/et specifike të projektit

Hartimi i një dokumenti të zhvillimit strategjik të turizmit liqenor dhe malor të zonës funksionale, që bashkërendon të gjitha pikat turistike të saj. Ky dokument do të ndihmojë njësinë vendore në përfitim të fondeve për ngritjen e infrastrukturës në zbatim të këtij plani, duke shërbyer dhe si sinjal për drejtimin e investimeve nga sipërmarrësit e zonës në fushën e turizmit.

Rezultatet e pritshme dhe treguesit

Rezultati kryesor i projektit do të jetë dokumenti i planit strategjik të zhvillimit të turizmit në zonën funksionale, në përfitim të administratës së ardhshme vendore për drejtimin e investimeve në infrastrukturë, si dhe të banorëve të saj, rreth 54555 banorë, si një mjet bazë i zhvillimit të sektorit të turizmit.

PROJEKTI 7



program i zonave funksionale

pzf

Aktivitetet e projektit

Projekti mund të përfshijë aktivitetet e mëposhtme:

- Ngritja e një grupi pune me ekspertë të territorit të Malësisë së Madhe dhe njohës të vlerave natyrore, kulturore, arkeologjike e historike të krahinës;
- Përgatitja e një harte turistike të Malësisë së Madhe, ku tregohen pikat e saj turistike, si dhe shtigjet e rrugët e kalimit;
- Hartimi i një plani strategjik të zhvillimit të turizmit malor dhe liqenor në zonë;
- Hartimi i paketave turistike gjithëpërfshirëse të zonës funksionale.

Realizimi i projektit mund të shtrihet në një hark kohor deri në gjashtë muaj.

Maturimi i projektit

Ky projekt është një ide, e cila vjen në përgjigje të nevojës për integrimin e zhvillimit të turizmit në Malësinë e Madhe si një njësi e vetme vendore dhe nxjerrjen në pah të pikave turistike.

Aktualisht ekzistojnë plane strategjike veprimi apo zhvillimi të turizmit, shpeshherë me objekt Liqenin e Shkodrës dhe pjesën e Alpeve të Shqipërisë. Nisur nga kjo, një aktivitet i nevojshëm paraprak për realizimin me sukses të këtij projekti mund të jetë bashkërendimi i planeve strategjike të kësaj natyre, që kanë në fokus një pikë turistike, një pjesë të zonës funksionale, ose që shtrihen në nivel ndërzonal, apo dhe ndërkufitar.

Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Donatorë të mundshëm të projektit janë: Ministria e Ekonomisë, IPA dhe GIZ.

Kostot e projektit

Kostoja e pritshme e ekspertizës së specializuar për këtë studim është 20,000 Euro.